



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 26.11.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 124, të datës 29.10.2024, paraqitur nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, shkronja (d), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (dh), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe nenin 9, paragrafi 3, të Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013 mori:

V E N D I M

Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025

1. Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, kryesues i grupit;
 - 1.2 Amir Bullatovci – Drejtori i Administratës, anëtar;
 - 1.3 Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar;
 - 1.4 Blerina Morina - Zyrtare e Lartë Ligjore, anëtare;
 - 1.5 Jetmir Berisha - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar;
 - 1.6 Durim Hajra - Përfaqësues i Lëvizjes Vetëvendosje, anëtar
 - 1.7 Aida Alimi - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare;
 - 1.8 Arbnore Kelmendi - Përfaqësuese e Nismës Socialdemokrate, anëtare;
 - 1.9 Hasan Ismajli - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar;
 - 1.10 Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtar;
 - 1.11 Artan Asllani - Përfaqësues i Listës Ndryshe, anëtar;
 - 1.12 Qëndresa Ademi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtare dhe
 - 1.13 Radoman Doderovic - Përfaqësues i Iniciativës Qytetare Serbe anëtare.
2. Pjesë përbërëse e Grupit Punues të cekur në pikën një të vendimit për përgatitjen e planeve të punës së Komiteteve të Kuvendit, janë edhe anëtarët tjerë përfaqësues të subjekteve

politike nga Kuvendi i Komunës, në kuadër të Komitete të Përhershme dhe Komiteteve tjera të themeluara me vendimet e Kuvendit të Komunës, me zëvendësimet tjera në përfaqësim.


3. Detyrë dhe përgjegjësi e Grupit Punues, nga pika një (1) dhe dy (2) e vendimit, është hartimi i Projekt-Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025 dhe planeve për Komitetet e Përhershme dhe Komitetet tjera.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Grupit Punues dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 02.12.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1471, të datës 25.11.2024, paraqitur nga Drejtorja e Arsimit, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 5, shkronja (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, (Gazeta Zyrtare Nr.30/2008), nenin 20, të Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, (Gazeta Zyrtare Nr. 17/2011), nenin 14, paragrafi 8, nën paragrafët 8.1, 8.2 dhe 8.3, të Rregullores së QRK Nr. 19/2024, për procedurat e përzgjedhjes, emërimit të drejtorëve dhe zëvendës drejtorit, mësimdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese IEAA të arsimit Para universitar, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj) të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 48, paragrafi 8, të Rregullores për Organizimin Kompetencat dhe Përgjegjësitë e Organeve të Administratës Komunale nr. 125, të datës 25.09.2014 mori:

V E N D I M


Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorëve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' dhe Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi 1 në Komunën e Fushë-Kosovës

1. Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Zëvendës drejtorëve të Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Selman Riza' dhe Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Mihal Grameno' - Aneksi 1 në Komunën e Fushë-Kosovës në përbërje prej tre anëtarëve si vijon:
 - 1.1 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë në Drejtorinë e Arsimit - Kryetare e Komisionit;
 - 1.2 Gëzim Berisha - anëtar i Komisionit, drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ulët 'Laura Scoti', në Graboc i Poshtëm;
 - 1.3 Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit
 - 1.4 Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në cilësinë e vëzhguesit dhe
 - 1.5 Një anëtar nga Këshilli i Mësimdhënësve- në cilësinë e vëzhguesit.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit, MASHTI, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.12.2024

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1436, të datës 14.11.2024, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 7, nenin 13, të 'Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M


Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Krijuesit të vitit 2024

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Krijuesit të vitit 2024', në përbërje prej gjashtë (6) anëtarëve:
 - 1.1 Arbnore Kelmendi - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.2 Habib Mekolli - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.3 Etnik Berjani - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.4 Vlora Berjani - Zyrtare e Lartë për Arsim, anëtare;
 - 1.5 Bajram Rexhepi - Zyrtar për Informim, anëtar dhe
 - 1.6 Përparim Uka – Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm për 'Krijuesin e vitit 2024'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivit.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.12.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 1436, të datës 14.11.2024, paraqitur nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (r), nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (m), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, nenin 8, nenin 13 të 'Rregullores për përmbytjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera', Nr. 83, të datës 06.06.2016 mori:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e Sportistëve të vitit 2024

1. Për formimin e Komisionit vlerësues për zgjedhjen e 'Sportistëve të vitit 2024', në përbërje prej gjashtë (6) anëtarëve:
 - 1.1 Fidan Berisha - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.2 Hasime Kostanica - Anëtare e Kuvendit të Komunës, anëtare;
 - 1.3 Bashkim Krasniqi - Anëtar i Kuvendit të Komunës, anëtar;
 - 1.4 Agron Breznica - Zyrtar për Sport, anëtar;
 - 1.5 Adnan Bullatovci - Zyrtar i Lartë për Mjedis, anëtar dhe
 - 1.6 Maliq Thaçi - Shoqëria Civile, anëtar.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit vlerësues, nga pika një e vendimit, është të shqyrtojë dhe vlerësojë kandidatët më të suksesshëm për 'Sportistët e vitit 2024'.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesueses së Kuvendit të Komunës,
Anëtarëve të Komisionit, Drejtorisë së KRS dhe Arkivit.**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKTION ZA ADMINISTRACIJE

Ref./Dest. 143
Datë/Catim. 03 12.2024
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.12.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2024, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 2095, të datës 15.11.2024, paraqitur nga Kryetari i Komunës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (o), nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (k), nenin 27, shkronja (gj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për ndryshim-plotësimin e vendimit Nr. 93, të datës 31.03.2022 për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën paragrafi 1.3, 1.6 dhe 1.7 të 'Komisionit për emërtimin rrugëve dhe vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës si vijon: Vlonjat Hasani - anëtar i Kuvendit të Komunës nga Lëvizja Vetëvendosje, Fatlum Berisha - Drejtor i Drejtorisë së Administratës dhe Ali Topalli - Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
2. Detyrë dhe përgjegjësi e Komisionit, nga pika një (1) e këtij Vendimi është 'Emërtimi i rrugëve të reja, shqyrtimi i ankesave të ndërlidhura me plotësim ndryshimin e emërtimit të rrugëve ekzistuese dhe emërtimin e vendeve tjera publike' në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Mandati i këtij Komisioni fillon nga hyrja në fuqi e këtij vendimi e deri në përfundim të mandatit zgjedhor 2021-2025. Komisioni për punën e tij i përgjigjet Kuvendit të Komunës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit dhe protokollimit në librin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të Komisionit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.12.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2024, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale, të paraqitur nga Kryetari i Komunës, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 24, të Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 06/2024, për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale


1. Për miratimin e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën Komunale.
2. Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Administratën e Komunës së Fushë-Kosovës, përfshinë mënyrën e organizimit dhe rregullimin e brendshëm, përgjegjësit e njëjseve organizative, klasifikimin, sistematizimin e vendeve të punës në Administratën e Komunës dhe organogramin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës është shtojca Nr. 1 për klasifikimin dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe shtojca Nr. 2 për organogramin e komunës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë e Kryetarit të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Administratës, Drejtorive tjera Komunale dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.12.2024

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më datë 26.11.2024, pas shqyrtimit të Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, të paraqitur nga Drejtoria e Arsimit, i shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetit për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Udhëzimit Administrativ Nr. 19/20212, për themelimin dhe fuqizimin e ekipeve për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos - regjistrimit në arsimin e obliguar, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026

1. Për miratimin e Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Plani i Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026, në të gjitha shkollat e Komunës së Fushë-Kosovës, parasheh zhvillimin e punëve dhe aktiviteteve për parandalimin e braktisjes së shkollës.
3. Pjesë përbërëse e 'Planit të Veprimit për parandalimin e braktisjes dhe mos - regjistrimit në shkolla për vitet 2024 - 2026'.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është kompetencë e Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Arsimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Arsimit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

